



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0655

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Agim Sad. Gashi B.I., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KOMUNA E PEJES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit 043 Ndertimi i rrethojave metalike ne varreza ne Pejë RITENDER Lot 1 Ndertimi i rrethojave metalike ne fshatin Broliq Qallapek Dardania 3 Lot 2 Ndertimi i rrethojave metalike ne fshatin Lutogllavë Leshan dhe Nabergjan Lot 3 Ndertimi i rrethojave metalike ne fshatin Jabllanice e madhe ,Maja e Zezë, lagjja Haxhi Zeka dhe Sari Sallteki , Shkolla Lybeniq dhe tek varrezat e qytetit me numër të prokurimit 635-25-4573-5-2-1, me 08.09.2025, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE Agim Sad. Gashi B.I. me nr. 2025/0655, e datës 16.07.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit 043 Ndertimi i rrethojave metalike ne varreza ne Pejë RITENDER Lot 1 Ndertimi i rrethojave metalike ne fshatin Broliq Qallapek Dardania 3 Lot 2 Ndertimi i rrethojave metalike ne fshatin Lutogllavë Leshan dhe Nabergjan Lot 3 Ndertimi i rrethojave metalike ne fshatin Jabllanice e madhe ,Maja e Zezë, lagjja Haxhi Zeka dhe Sari Sallteki , Shkolla Lybeniq dhe tek varrezat e qytetit me numër të prokurimit 635-25-4573-5-2-1, për LOT 1.

2. **Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KOMUNA E PEJES, ndërkaq aktiviteti i prokurimit 043 Ndertimi i rrethojave metalike ne varreza ne Pejë RITENDER Lot 1 Ndertimi i rrethojave metalike ne fshatin Broliq Qallapek Dardania 3 Lot 2 Ndertimi i rrethojave metalike ne fshatin Lutogllavë Leshan dhe Nabergjan Lot 3 Ndertimi i rrethojave metalike ne fshatin Jabllanice e madhe ,Maja e Zezë, lagjja Haxhi Zeka dhe Sari Sallteki , Shkolla Lybeniq dhe tek varrezat e qytetit me numër të prokurimit 635-25-4573-5-2-1 për LOT 1 të kthehet në **Rivlerësim**.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Agim Sad. Gashi B.I.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 23.05.2025 Komuna e Pejës, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit 043 Ndertimi i rrethojave metalike ne varreza ne Pejë RITENDER Lot 1 Ndertimi i rrethojave metalike ne fshatin Broliq Qallapek Dardania 3 Lot 2 Ndertimi i rrethojave metalike ne fshatin Lutogllavë Leshan dhe Nabergjan Lot 3 Ndertimi i rrethojave metalike ne fshatin Jabllanice e madhe ,Maja e Zezë, lagjja Haxhi Zeka dhe Sari Sallteki , Shkolla Lybeniq dhe tek varrezat e qytetit me numër të prokurimit 635-25-4573-5-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës për LOT I: 65,360.00 €.

Me 02.07.2025, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë LOT I OE “ Izet Doda B.I.”.

Me 07.07.2025, OE Agim Sad. Gashi B.I., ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 07.07.2025.

Me 16.07.2025, OE Agim Sad. Gashi B.I., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/0655, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik Agim Sad. Gashi B.I., lidhur me ankesën 0655/2025:

Pretendimi 1

Në pikën 9.2 dhe 9.3, konkretisht Kapaciteti Teknik dhe Profesional, kërkesa e AK për Menaxherin e Projektit është si më poshtë:

Kapaciteti teknik dhe profesional

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Për (LOT-1), (LOT-2) dhe (LOT-3):

Kërkesa 2: Menaxheri i Projektit duhet të jetë Inxhinier Ndërtimi – drejtimi Konstruktiv, i certifikuar si Lead Auditor sipas standardit EN ISO 9001:2015, me minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit.

Dëshmia 2

Për të vërtetuar përfshirjen e inxhinierit në projekt, duhet të paraqiten këto dokumente:

Diploma dhe CV-ja e nënshkruar nga vetë inxhinieri;

Kontrata ose marrëveshja e bashkëpunimit për këtë projekt;

Vendimi për caktimin si menaxher projekti;

Certifikatat përkatëse profesionale.

Pra, kërkohet që Menaxheri i Projektit të jetë Inxhinier i Ndërtimtarisë – drejtimi Konstruktiv, i certifikuar si Lead Auditor ISO 9001:2015, me 3 vite përvojë pune pas diplomimit. Dhe tek dëshmia e kapacitetit profesional kërkohet që vendimi për menaxherin të caktohet nga OE, me certifikatat përkatëse.

OE në fjalë ka ofruar një listë të stafit profesional në të cilën nuk specifikohet në asnjë vend pozita e stafit dhe as nuk është e vulosur apo nënshkruar.

Por në vendimin për Menaxher të Kontratës ka prezantuar Inxhinierin Mentor Beqiri si menaxher të projektit.

Pas verifikimit të dokumenteve, nuk kemi gjetur askund që ky inxhinier është i certifikuar me ISO 9001:2015 sipas kërkesës në DTF. Madje nuk është prezantuar as dëshmia elementare për ta vërtetuar që ky është inxhinier i ndërtimtarisë (mungon diploma, CV-ja, referencat, certifikata dhe kontrata apo marrëveshja për bashkëpunim me “inxhinierin” në fjalë).

Pretendimi 2

Duke iu referuar Dosjes së Tenderit, Kapaciteti Teknik dhe Profesional: OE e rekomanduar për kontratë nga AK nuk ka ofruar stafin sipas kërkesës së DTF-së, dëshmitë të cilat i ngarkojmë më poshtë, dhe në listën e stafit nuk ka shënuar askund që posedon apo ofron një saldues me IWS apo saldues të certifikuar sipas EN ISO 9606. Këta nuk janë prezantuar as në listë dhe as me dokumentacion.

Kërkesa 3

Stafi teknik që do të angazhohet drejtpërdrejt në këtë projekt duhet të përbëhet nga minimum katër (4) punonjës, si më poshtë:

Një (1) Teknik i Makinerisë;

Një (1) person i certifikuar si Lllamarinpunues (me certifikatë ose diplomë të shkollës së mesme përkatëse);

Një (1) Saldues i certifikuar me IWS (International Welding Specialist);

Një (1) Saldues i certifikuar sipas standardit EN ISO 9606.

Dëshmia 3

Për të vërtetuar përfshirjen e stafit teknik në projekt, duhet të paraqiten dokumentet e mëposhtme: diplomat, certifikatat profesionale për secilin anëtar të stafit, kontratat e punës ose parakontratat të lidhura në emër të projektit, që dëshmojnë angazhimin e tyre të drejtpërdrejtë.

Pra, OE e cila është poentuar me 95.00 pikë nga Komisioni i Vlerësimit nuk ka prezantuar as edhe një nga salduesit sipas kërkesës së DTF-së.

Paradoksi më i madh është se si gjithë këto mungesa nuk i ka vërejtur gjatë vlerësimit AK dhe Komisioni Vlerësues. Si ka mundësi që të mos respektohet as edhe një nen i Ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës dhe i Rregullores RrPP. Është për t'u habitur se si abuzohet kaq hapur me fondet publike të Republikës së Kosovës.

Pra, mungojnë në dosjen e ofruar:

Një (1) Teknik i Makinerisë;

Një (1) person i certifikuar si Lllamarinpunues;

Një (1) Saldues i certifikuar me IWS (International Welding Specialist);

Një (1) Saldues i certifikuar sipas standardit EN ISO 9606.

AK as nuk ka kërkuar sqarim nga OE, por automatikisht e ka vlerësuar me 95 pikë si ofertën më të përgjegjshme në procedurën e tenderimit, kur i njëjti nuk ka prezantuar as edhe një dëshmi për stafin profesional.

AK nuk ka marrë parasysh as nenin 59 të LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, që duhet të bëhet në përputhje me rregulloren.

Me këtë vendim të AK-së ne ndihemi të diskriminuar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, ndërsa në paragrafin 1 të nenit 7 të LPP-së parashihet qartë:

“Autoriteti kontraktues do t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”.

Pretendimi 3

Pas kërkesës për rishqyrtim më datë 07.07.2025, nga ana jonë, AK ka bërë shkelje duke mos e marrë parasysh fare kërkesën tonë për rishqyrtim, pasi arsyetimi i tyre ishte se ankesa është dërguar nga anëtar i autorizuar dhe jo si grup i operatorëve, duke gjetur bazë ligjore në nenin 108/A paragrafi 2. Me këtë, mendojmë që AK na ka diskriminuar për herë të dytë radhazi.

Andaj, i drejtohem OSHP-së që ta vlerësojë ankesën tonë dhe ta marrë si të bazuar. Madje, duke e parë procedurën, mendojmë që OSHP duhet të marrë edhe hapa të tjerë që janë në kompetencat e saj.

Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ta ketë parasysh ankesën tonë dhe lëndën ta kthejë në rivlerësim, duke e detyruar AK-në që të na shpërblejë me kontratë në LOT-1, pasi që jemi e vetmja OE e përgjegjshme në atë procedurë të prokurimit (lëne për të dëshiruar edhe lotët tjerë, por ankesa jonë është vetëm për LOT-1).

Në këtë rast, OE e rekomanduar për kontratë duhet të shpallet e papërgjegjshme në bazë të fakteve të ofruara dhe të eliminohet drejtpërdrejt nga procedura.

Ne duam të besojmë që me të vërtetë ka qenë një lëshim nga ana e komisionit vetëm për vlerësues të AK-së, pasi që nuk ka marrë parasysh asnjë nga pretendimet tona, madje duke mos e marrë fare për bazë kërkesën për rishqyrtim.

Ne si OE e konsiderojmë veten të diskriminuar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, ndërsa në paragrafin 1 të nenit 7 të LPP-së parashihet qartë:

“Autoriteti kontraktues do t’i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”.

Autoriteti kontraktues, në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, nuk ka dhënë arsyetim të bazuar, të qëndrueshëm dhe profesional, gjë që na bën të dyshojmë se kjo nuk ishte lëshim nga AK, por ishte favorizim dhe premtim i mëhershëm për këtë procedurë.

Pasi që autoriteti kontraktues nuk i ka shqyrtuar dhe nuk i ka kundërshtuar apo pranuar fare pretendimet tona ankimore, kërkojmë nga ana e ekspertit shqyrtues dhe panelit shqyrtues të OSHP-së t’i analizojnë në tërësi pretendimet tona ankimore dhe të nxjerrin një vendim përfundimtar të mbështetur në dispozita ligjore.

Me këtë rast, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë sipas nenit 59 të LPP-së dhe nuk është respektuar as neni 7 i LPP-së, ku parashihet që autoriteti kontraktues do t’i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Po ashtu, paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që:

“Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse”, kurse OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

Gjithashtu, kërkojmë nga OSHP që të ketë parasysh edhe nenin 65 pika 1.14.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Operatori Ekonomik Agim Sad. Gashi B.I. me datën 06.07.2025, ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Prok: Lot 1 Ndërtimi i rrethojave metalike në fshatin Broliq Qallapek Dardania 3 me nr. të prokurimit: 635-25-4573-5-2-1 nr. i 635-25-011-521.

Autoriteti Kontraktues, me datën 07.07.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Me datë 06.07.2025, Autoriteti Kontraktues ka pranuar një kërkesë për rishqyrtim nga Operatori Ekonomik Agim Sad. Gashi B.I., lidhur me aktivitetin e prokurimit të sipërpërmendur. Pas shqyrtimit të kërkesës, është konstatuar se operatori ekonomik ankimues ka marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit si pjesë e një Grupi të Operatorëve Ekonomikë, përkatësisht në grup me VIANTE KONSTRUKSION.

Këtë qartësisht mund ta shohim edhe në fletën e Kërkesës për Rishqyrtim, ku identifikimi i operatorit ekonomik është "Agim Sad. Gashi B.I.". Po ashtu, edhe vula i përket vetëm OE-së "Agim Sad. Gashi B.I.". Këtu nuk shihet se kërkesa për rishqyrtim është bërë në emër të grupit, ashtu siç parashihet me Ligjin për Prokurimin.

Baza ligjore – Neni 108/A i LPP-së

Neni 108/A, paragrafi 2 i Ligjit për Prokurimin Publik (Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar me ligjet pasuese) thotë qartë:

"Kur një grup i operatorëve ekonomik merr pjesë së bashku në një aktivitet prokurimi, çdo kërkesë për rishqyrtim apo ankesë duhet të paraqitet në emër të të gjithë grupit, përndryshe ajo do të konsiderohet si e papranueshme."

Ky nen është shumë i qartë në lidhje me rastet kur kemi konsorcium ose grup të OE-ve që marrin pjesë së bashku në një tender publik. Sipas këtij dispozicioni:

Vetëm i gjithë grupi mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim ose ankesë.

Kërkesa nuk mund të bëhet nga një pjesëtar i vetëm i grupit, edhe nëse është lideri i grupit, nëse kjo nuk autorizohet shprehimisht nga të gjithë anëtarët.

Nëse ankesa bëhet vetëm nga një pjesëtar i grupit dhe nuk është në emër të të gjithë grupit, ajo konsiderohet e papranueshme.

Aplikimi në rastin konkret

Në rastin tuaj:

Oferta është dorëzuar nga një grup OE, ku lider ishte VIANTE KONSTRUKSION dhe një nga anëtarët ka qenë Agim Sad. Gashi B.I.

Kërkesa për rishqyrtim është dorëzuar vetëm nga Agim Sad. Gashi B.I., jo në emër të të gjithë grupit.

Në sistemin e e-prokurimit, në pikën A të formularit për kërkesë rishqyrtimi, është deklaruar "JO" në pyetjen "A është bërë kërkesa në emër të grupit të OE?", që do të thotë se vetë deklaruesi e ka pranuar që kjo nuk është bërë në emër të grupit.

Sipas kësaj:

Kërkesa nuk është bërë në emër të të gjithë grupit të operatorëve ekonomik.

Kjo është në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së.

Si rrjedhojë, kërkesa për rishqyrtim është e papranueshme dhe Autoriteti Kontraktues – Komuna e Pejës ka të drejtë ta refuzojë atë pa shqyrtim të mëtejshëm të meritës së çështjes.

Bazuar në të gjitha të dhënat e lartpërmendura dhe sipas nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik:

Kërkesa për rishqyrtim e paraqitur vetëm nga Agim Sad. Gashi B.I., si anëtar i një grupi OE, pa autorizim dhe pa u paraqitur në emër të të gjithë grupit, është në kundërshtim me LPP-në dhe është e papranueshme.

Prandaj, vendimi i Autoritetit Kontraktues për të mos e pranuar këtë kërkesë është në përputhje me LPP-në dhe Rregullat.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 18.07.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0655, ndërsa me datë 28.07.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0655. Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës LOT I, dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Agim Sad. Gashi B.I., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0655, ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Pejës gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës punë. Vlera e parashikuar për LOT I 65,360.00 €. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara Aneksin 7.

Sqarim hyrës: Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 27, 59, 64, 65, 66, 68, 69 dhe 72 të LPP-së. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ndërsa oferta e operatorit ekonomik ankues është shpallur si ofertë e pasuksesshme sipas Letrës standarde për tenderuesin e pasuksesshëm. Pretendimet e ngritura ankimore nga ana e operatorit ekonomik ankues janë shqyrtuar nga eksperti duke u bazuar në shkresat e lëndës, dhe jep përgjigjeje si në vijim.

Pretendimi ankimor 1: OE ankues “Agim Sad.Gashi” B.I, pretendon se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë “Izet Doda B.I”, nuk i ka plotësuar kriteret e dosjes se tenderit. Në

kërkesën e AK-së është kërkuar që menaxheri i projektit të jetë inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv i certifikuar si Lead Auditor 9001:2015, me 3 vite përvojë pune pas diplomimit.

Ndërsa tek dëshmia kërkohet që vendimi për menaxherin të caktohet nga OE me certifikatë përkatëse OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një listë të stafit profesional në të cilën nuk specifikohet në asnjë vend pozita e stafit dhe as nuk është e vulosur apo nënshkruar.

Tutje OE ankues shton se në vendimin për menaxher të kontratës OE i rekomanduar ka prezantuar Inxhinierin Mentor Beqiri menaxher të projektit, pas verifikimit të dokumenteve nuk kemi gjet se ky inxhinier është i certifikuar me ISO:9001:2025, sipas kërkesës se DT nuk janë prezantuar as dëshmitë elementare për të vërtetuar që ky inxhinier është inxhinier i ndërtimtarisë. Andaj mungon diploma, cv-ja referencat certifikata dhe kontrata apo marrëveshja për bashkëpunim me inxhinierin në fjalë.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1: Ekspertja shqyrtuese sqaron se tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, AK ka kërkuar:

Për (LOT-1) & (LOT-2) dhe (LOT 3) Kërkesa 2 Menaxheri i Projektit duhet të jetë Inxhinier Ndërtimi – drejtimi Konstruktiv, i certifikuar si Lead Auditor sipas standardit EN ISO 9001 2025, me minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare :

Për (LOT-1) &(LOT-2) dhe (LOT 3) Dëshmia 2 Për të vërtetuar përfshirjen e inxhinierit në projekt, duhet të paraqiten këto dokumente, Diploma dhe CV-ja e nënshkruar nga vetë inxhinieri, Kontrata ose marrëveshja e bashkëpunimit për këtë projekt, Vendimi për caktimin si menaxher projekti, Certifikatat përkatëse profesionale.

Në lidhje me këtë kërkesë, OE i rekomanduar “Izet Doda B.I”, për kontratë me ofertë ka bashkangjitur dokumentin me titull: 5. LISTA STAFIT INXHINIERI VENDIMI STAFI TEKNIK CE...pdf, 6. CERTIFIKATAT.pdf

Pas shqyrtimit të këtyre dokumenteve sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë ka bashkangjitur:

listën e stafit të vulosur, në përbërje prej një inxhinieri dhe katër punëtorëve në cilësinë e stafit teknik;

vendimin për caktimin e menaxherit të projektit, Mentor Beqiri si menaxher i projektit, të bashkangjitur para kontratës me inxhinierin Mentor Beqiri. Po ashtu, është bashkangjitur diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, drejtimi Konstruktiv, pastaj është bashkangjitur CV e inxhinierit dhe e nënshkruar nga vet Mentor Beqiri.

Kurse, sa i përket kërkesës së dosjes së tenderit në lidhje me “Menaxheri i Projektit duhet të jetë Inxhinier Ndërtimi – drejtimi Konstruktiv, i certifikuar si Lead Auditor sipas standardit EN ISO 9001 2025, me minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit” dhe për këtë kërkesë është kërkuar që të dëshmohet me “Certifikatat përkatëse profesionale”, ekspertja shqyrtuese sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka bashkangjitur disa certifikata, sikurse certifikatën TS EN ISO 9001:2015, “International Welding Specialist”, “Welder Qualification Test Certificate BS EN ISO 9606-1:2013”, “Urkunde Nr. 21 2016 000 144”, “Attestation Certificate of Machinery and Low VOLTAGE Directives”, “Certificate ISO 9001:2008”, “Patent Cetificate for Utility

Model”, “Certificate of Grant Innovation Patent”.

Pra, sipas kërkesës së AK është kërkuar që menaxheri i projektit të jetë i certifikuar si “Lead Auditor sipas standardit EN ISO 9001 2025”, kurse në asnjërën prej certifikatave të lartcekura nuk është emri i menaxherit të projektit Mentor Beqiri. Në lidhje me këtë kërkesë, me datë 25.07.2025, përmes e-mailit zyrtar i jemi drejtuar autoritetit kontraktues me kërkesë për sqarime në lidhje me certifikatën në fjalë, mirëpo AK nuk ka kthyer përgjigje. Andaj, pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi ankimor 2: OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar stafin sipas kërkesës së DT, nuk posedon një saldues me IËS apo saldues të certifikuar sipas EN ISO 9606 pasi nuk i ka prezantuar as në listë e as me dokumentacion. Tutje, OE ankues shton se OE i cili është poentuar me 95.00 pikë nga komisioni i vlerësimit, nuk ka prezantuar as edhe një saldues sipas kërkesës së DT. Andaj, në dosjen e ofruar mungon një teknik i makinerisë, një person i certifikuar si Lllamarin punues, një saldues i certifikuar me IWS (international welding specialist), një saldues i certifikuar sipas standardit EN ISO 9606. AK nuk ka kërkuar sqarime nga OE por ka vlerësuar me 95 pikë si ofertë e përgjegjshme, AK ka bërë shkelje të nenit 59 dhe 7 të LPP-së.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2: Ekspertja shqyrtuese sqaron se tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale AK ka kërkuar:

Për (LOT-1) &(LOT-2)dhe (LOT 3)Kërkesa 3 Staf i teknik që do të angazhohet drejtpërdrejt në këtë projekt duhet të përbëhet nga minimum katër (4) punonjës, si më poshtë Një (1) Teknik i Makinerisë, Një (1) person i certifikuar si Lllamarin punues (me certifikatë ose diplomë të shkollës së mesme përkatëse), Një (1) Saldues i certifikuar me IWS (International Welding Specialist), Një (1) Saldues i certifikuar sipas standardit EN ISO 9606.

Dëshmia e kërkuar dokumentare :

Për (LOT-1) &(LOT-2)dhe (LOT 3) Dëshmia 3 Për të vërtetuar përfshirjen e stafit teknik në projekt, duhet të paraqiten dokumentet e mëposhtme Diplomat , certifikatat profesionale për secilin anëtar të stafit, Kontratat e punës ose parakontratat të lidhura në emër të projektit, që dëshmojnë angazhimin e tyre të drejtpërdrejtë

Në lidhje me këtë kërkesë, OE i rekomanduar për kontratë “Izet Doda B.I”, me ofertë ka bashkangjitur dokumentin me titull: 5. LISTA STAFIT INXHINIERI VENDIMI STAFI TEKNIK CE...pdf, 6. CERTIFIKATAT.pdf

Ekspertja shqyrtuese sqaron se pas shqyrtimit të këtyre dokumenteve sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë ka bashkangjitur:

listën e stafit të vulosur, në përbërje prej një inxhinieri dhe katër punëtorëve në cilësinë e stafit teknik;

para kontratë me stafin teknik “saldues”, e lidhur me Guxim Loxha;

para kontratë me stafin teknik “llamarist”, e lidhur me Donat Daci.

Pra, nga dokumentet e bashkangjitura me ofertë të OE të rekomanduar për kontratë janë vetëm këto dy para kontrata për staf teknik dhe nuk është bashkangjitur certifikatë ose diplomë e

shkollës së mesme për llamarinë punuesin sipas kërkesës së DT-së dhe nuk është bashkangjitur certifikata IOS për salduesin, si dhe certifikata për salduesin tjetër sipas standardit EN ISO 9606.

Vlen të theksohet se në lidhje me certifikatat IWS dhe EN ISO 9606 për salduesit, OE i rekomanduar për kontratë i ka bashkangjitur disa certifikata të cilat janë cekur te përgjigja e pretendimit të parë, mirëpo në asnjërën prej këtyre certifikatave nuk evidentohet ndonjë emër i ndonjë personi. Edhe për këtë kërkesë kemi kërkuar sqarime nga AK sipas emailit të cekur më lartë, mirëpo nuk kemi pranuar përgjigje.

Pretendimi ankimor 3: OE ankues pretendon se AK ka bërë shkelje duke mos marrë parasysh fare kërkesën për rishqyrtim pasi që arsyetimi i tyre ishte që ankesa është dërguar nga anëtari i autorizuar dhe jo si grup i operatorëve duke u bazuar në nenin 108/A paragrafi 2, me të cilën mendojmë që AK na ka diskriminuar për të dytën herë radhazi.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3: Ekspertja shqyrtuese bazuar në nenin 108/A par. 5 të Ligjit për Prokurim Publik, AK është i obliguar që të kërkoj sqarime dhe plotësim të kërkesës për rishqyrtim dhe jo të refuzoj kërkesën menjëherë. Andaj pretendimi i OE ankues është i bazuar, për faktin se AK nuk ka respektuar nenin 108/A gjatë trajtimit të kërkesës për rishqyrtim.

Ndërsa par. 5 i nenit 108/A të LPP-së ka përcaktuar: 5.Nëse aplikimi nuk përmban disa nga informacionet referuar në paragrafin 4 të këtij neni, autoriteti kontraktues do të kërkojë nga ankuesi që të plotësoj kërkesën e tij Brenda një periudhe jo më të gjatë se dy (2) ditë nga marrja e kërkesës. Nëse parashtuesi i ankesës nuk vepron sipas kërkesës së lartpërmendur, kërkesa për rishikim do të refuzohet si e paplotë.

Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, vlerësimi ynë është se vlerësimi i ofertave nuk është bërë në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, përkatësisht nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, prandaj rekomandoj që LOT I, të kthehet në rivlerësim.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit 043 Ndertimi i rrethojave metalike ne varreza ne Pejë RITENDER Lot 1 Ndertimi i rrethojave metalike ne fshatin Broliq Qallapek Dardania 3 Lot 2 Ndertimi i rrethojave metalike ne fshatin Lutogllavë Leshan dhe Nabergjan Lot 3 Ndertimi i rrethojave metalike ne fshatin Jabllanice e madhe ,Maja e Zezë, lagjja Haxhi Zeka dhe Sari Sallteki , Shkolla Lybeniq dhe tek varrezat e qytetit me numër të prokurimit 635-25-4573-5-2-1.,.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtesat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues dhe ja fal besimin që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës për LOT – I dhe lënda të

kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES**
- **OE - Agim Sad. Gashi B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: